

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
SEKRETARIA

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.08.2020

**Për mbledhjen Nr. 33, datë 28.08.2020, ora 10:00  
Të Bordit të ERE-s**

Në zbatim të (i) nenit 13 të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; të ndryshuar, (ii) Rregullores bazë së Organizimit dhe Funkcionimit të Entit Rregullator të Energjisë të miratuar me Vendimin e ERE-s Nr. 144/2019 dhe (iii) nenit 11 të “Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s” miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr.96, datë 16.07.2016, (iv) Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave Nr. 8, datë 24.03.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në aktin normativ nr. 3, datë 15.03.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të vecanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID – 19”, të ndryshuar, njoftojmë se **ditën e Premte, datë 28.08.2020, ora 10:00** do të zhvillohet mbledhja nr. 33 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

**1-** Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE nr. 72, datë 22.04.2020 “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “Green Energy Trading Albania” sh.p.k., nr. 286, seria T15, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të komisionerëve të ERE-s nr. 59, datë 23.04.2015”

**2-** Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Koka & Ergi Energy Stavec” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Stavec” me kapacitet të instaluar 6000 kW (sipas kontratës së koncesionit)

**3-** Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Mateo & Co” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Murasi” me kapacitet të instaluar 2 MW, në lumin e Cemit të Selcës, degë e lumit Cem i bashkur, në Bashkinë Malësi e Madhe, Qarku Shkodër

**4-** Mbi fillimin e procedurës për miratimin e draftit të “Kushteve të përgjithshme të kontratës tip të furnizimit me gaz natyror për klientët fundorë që përfitojnë nga shërbimi publik i furnizimit

**5-** Çështje të tjera

Në zbatim të pikës 1 të Urdhërit të kryetarit të ERE-s nr. 53, datë 11.03.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-2019”; Urdhërit nr. 53/1, datë 24.03.2020 “Për një ndryshim në urdhërin nr. 53, datë 11.03.2020”, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore” dhe Urdhërit nr. 53/2 datë 01.06.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin

e mbledhjeve apo seancave dëgjimore gjatë gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19, mbledhja nuk do të jetë e hapur për publikun.

**KRYETARI I ERE**  
**Petrit AHMETI**